

Depozita me Afat për Klientë Individë (18 Mujore)

Informacion rreth Bankës

Intesa Sanpaolo Bank Albania

Drejtoria Qendrore: Rr" Ismail Qemali, Nr. 27,
Kutia postare 8319
1001 Tirane, Shqipëri
Tel: +355 4 22 76 000; Fax +355 4 22 48 762
Website: www.intesasanpaolobank.al

Karakteristikat dhe rreziqet e Depozitës 18 Mujore

Karakteristikat e Depozitës 18 Mujore

Depozita "18 Mujore" është një depozitë me afat, një investim afat-mesëm/gjatë me një përfitim afat-shkurtër të interesit. Kjo depozitë mund të hapet vetëm në Lek. Nuk ka asnjë limit për shumën që do të investohet. Fondet për këtë depozitë kanalizohen nëpërmjet llogarisë rrjedhëse të klientit. Në datën e maturimit depozita nuk është e rinovueshme, dhe në këtë datë principali dhe interesi (*minus tatimin në burim*) do të kreditohen në llogarinë rrjedhëse të klientit.

Interesi i depozitës është me bazë vjetore dhe likuidimi i tij bëhet 2 herë gjatë jetës së depozitës:

Pas 12 muajve të parë të depozitës;

Pas 6 muajve të fundit (*në maturitet*);

Klienti mund ta thyej depozitën në çdo kohë para maturitetit, por nëse depozita thyhet penalteti që ai duhet të paguajë është si me poshtë vijon:

Gjate 12 muajve të parë, klienti nuk përfiton asnjë interes;

Gjatë 6 muajve të fundit, klienti përfiton interesat e kaluar në llogari për vitin e parë dhe asnjë interes për muajt e fundit (*pas vitit të parë*)

Tregu i synuar

Tregu i synuar për depozitat me afat janë të gjithë klientët që duan të kursejnë para për një periudhë afat gjatë dhe në të njëjtën kohë të fitojnë interesa.

Klientet ekzistues, depozitat e të cilëve "Mundem Benefit", do të maturohen gjatë periudhës së fushatës dhe duan të ri-investojnë në një periudhë më të gjatë përsëri me një nga normat më të mirë të interesit në treg;

Klientët e Rinj & Konsumatorët ekzistues me "Fresh money" në veçanti emigrantët që sjellin për investim kursimet e tyre gjatë kohës së verës;

Depozitat afatshkurtra të bankave të tjera me maturitet gjatë periudhës së fushatës tone, duke pasur në konsideratë normat tona të interesit të cilat janë shumë të favorshme;

Klientet ekzistues të depozitave në euro, që dëshirojnë të konvertojnë depozitat e tyre në monedhën Lek;

Dokumentet e nevojshme

Pasaportë/Kartë Identiteti

Kontrata e Depozitës

Kërkesa për Depozitë me Afat

Rreziqet e Depozitës 18 Mujore

1. Kompensimi i depozitave bazohet në nenin 33, paragrafi 1, pika a) e Ligjit nr. 53/2014, datë 22/05/2014 "Për sigurimin e depozitave", në bazë të të cilit ASD siguron dhe kompenson depozitat e çdo depozituesi në Bankë ose në degën e bankës së huaj deri në masën 100 përqind, por në çdo rast jo më shumë se Lek 2,500,000 (dy milion e pesëqind mijë), pavarësisht nga numri i depozitave dhe monedha e tyre, që janë depozituar në Bankë.

2. Llogaria rrjedhëse që lidhet me depozitën me afat është pa komision vetëm nëse përdoret ekskluzivisht për transaksionet e depozitës me afat dhe nuk lidhet me ndonjë produkt tjetër, në të kundërt do të aplikohet komisioni i mirëmbajtjes mujore sipas Kushteve të Punës në fuqi.

3. Në rastin e depozitës në një monedhë të ndryshme nga monedha e të ardhurave, ekziston rreziku që lidhet me luhatjen e normave të interesit.

Kushtet kryesore ekonomike

Lista e të gjitha kostove dhe shpenzimeve të produktit:

Normat e Interesit LEK (%)

| | |
|------------|------|
| M12 | 1.10 |
| M18 | 1.70 |

Komision Mirëmbajtje

Komision i mirëmbajtjes së llogarisë ALL * Falas

*Të lutem referoju pikës 2 ne seksionin e "Rreziqet e Depozitës 18 Mujore"

Tatim i mbajtur në burim

Tatimi në burim aplikohet sipas ligjit shqiptar i pagueshëm në momentin e përfuturimit të interesit 15% e interesit të përfutur

Kosto të tjera të lidhura me depoziten

| | |
|-------------------------------------|--|
| Lëvizjet e Aktivitetit të Depozites | Falas |
| Rritja e shumës së depozites | Jo e aplikueshme |
| Ulja e shumës së depozites | Jo e aplikueshme |
| Lëshimi i konfirmimit bankar | 1000 Lek (Opsionale, sipas kërkesës së klientit) |

Likuidimi i interesit*

| | 12 M | 18 M |
|--|---------------------------------|-------------|
| Shuma | 100,000 LEK | 100,000 LEK |
| Interesi Bruto | 1,100 LEK | 1,700 LEK |
| Taksa | 165 LEK | 255 LEK |
| Interesi Neto | 935 LEK | 1,445 LEK |
| Periodiciteti i interesit dhe pagesës së taksave | Në fund të periudhës respektive | |
| Data e likuidimit të interesit | Në fund të periudhës respektive | |

*Shembull ilustrativ

Tërheqja para afatit, ndryshimi i njëanshëm i kushteve kontraktore dhe ankesat

Tërheqja nga Kontrata

Tërheqja e pjesshme: Nuk lejohet

Likuidimi i parakohshëm: Lejohet (Shuma e plotë)

Në rastin e likuidimit të parakohshëm të Depozites 18 Mujore, klienti do të përfitojë:

- Gjatë 12 muajve të parë, klienti nuk përfiton asnjë interes;
- Gjatë 6 muajve të fundit, klienti përfiton interesat e kaluar në llogari për vitin e parë dhe asnjë interes për muajt e fundit (pas vitit të parë)

Ndryshimi i njëanshëm i kushteve kontraktore

Çdo ndryshim i kushteve, i cili përcaktohet në mënyrë të shprehur në kontratën e depozitës, do të jetë efektiv pas dakordësisë me shkrim të palëve. Asnjë ndryshim i kushteve të përcaktuara shprehimisht në kontratën e llogarisë nuk do të jetë efektiv nëse nuk janë dakordësuar me shkrim midis palëve.

Ankesat

Ankesat do të paraqiten në bankë duke përdorur një nga format e mëposhtme:

- Në formë shkresore përmes postës zyrtare të bankës;
- Në "Kutinë e ankesave & sugjerimeve" që ndodhet në degë (Ju dëgjojmë 100%);
- Ankesa me shkrim të cilat dërgohen nëpërmjet faqes të internetit të bankës në adresën zyrtare të email-it: complain@intesasanpaolobank.al
- Në Qendrën e Kontaktit : 08006000

Koha e kthimit të përgjigjes nga ana e Bankës është maksimumi brenda 30 ditë nga data e marrjes së ankesës.

Fjalorthi i Termave Kryesore

ASD- Agjencia e Sigurimit të Depozitave (Agjencia) është person juridik publik, me seli në Tiranë, e cila ushtron funksionet e saj, me qëllim përmbushjen e objektivave në zbatim të Ligjit Nr. 53/2014, datë 22.05.2014, "Për Sigurimin e Depozitave".

Interesi Neto- vlera bruto e interesit minus tatimin në burim

Tatimi ne burim - është një kërkesë e qeverisë për pagesin për një të ardhur të tatueshme në burim ose tatimin e zbritshëm nga pagesa në favor te qeverisë .Ky tatim aplikohet më së shumti në të ardhurat nga puna , pagesa interesash ose dividendë.

Penalitet- Vlera e interesit e gjeneruar por jo e përfituar prej klientit